

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nisja e vitit të ri shkollor, Hita mbledh drejtuesit e Policisë në Elbasan, Berat e Kukës: Angazhim maksimal për sigurinë e nxënësve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/nisja-e-vitit-te-ri-shkollor-hita-mbledh-drejtuesit-e-policise-ne-elbasa-i584270
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 11:18:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 11:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	26afe77faebf614511cacef46c95a1b34f2daada4811c9f9d032ebc0f741dca5
TEKSTI	648b1b13f862e69398824386f3b425e0fc25fb2f81c8becbb5a59b8a5e8b6a78
PAMJA	50c4692779f7428a3671c6a422adb0e780acff7ec96cdb88e7119cd7c5346806

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	58b8ed9ab8d29bbb7217dfceca8772fc671e76ee70d4240903e736c303695bdf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9b0ef5cb548784d84290a5a2cc7ced9efd92dc80ea79fd946771fbc60f10815e
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmdjMmLmnJ4wB8Euqv7vxq3nG8KM5prDgsKUKfETtSW5Z



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/58b8ed9ab8d29bbb7217dfceca8772fc671e76ee70d4240903e736c303695bdf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e ["Tragjedi ne Kepin e Gjeiber, autobusi me studente bie nga 30 metra" Te pakten 21 viktima "IIF" hapet me himin "Mother" Rendohe n dëshkimet, shtohen shkeljet/ Pas nd fundit](#)

Nisja e vitit të ri shkollor, Hita mbledh drejtuesit e Policisë në Elbasan, Berat e Kukës: Angazhim maksimal për sigurinë e nxënësve



6 Shtator 2026, 13:25Kronika TEMA



Siguria në shkolla me nisjen e vitit të ri mësimor, lufta kundër armëmbajtjes pa leje dhe narkotikëve, si edhe ndjekja e denoncimeve të qytetarëve, ishin në fokus të takimeve që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, zhvilloi me drejtuesit e Policisë në Elbasan, Berat dhe Kukës.

Në takimet me strukturat vendore, Hita kërkoi rritjen e parametrave të sigurisë, duke vënë theksin te parandalimi i ngjarjeve kriminale, ndjekja në kohë reale e konflikteve dhe denoncimeve të qytetarëve, identifikimi dhe arrestimi i personave që qarkullojnë me armë zjarri apo ushtrojnë veprimtari në fushën e narkotikëve, kapja e personave në kërkim, si dhe parandalimi i krimeve mjedisore. Ai kërkoi gjithashtu që komunikimi me qytetarët të jetë gjithmonë etik dhe profesional.

Një pjesë e rëndësishme e porositve të Drejtorit të Përgjithshëm ishte siguria në shkolla, të cilën ai e cilësoi si prioritetin kryesor të Policisë së Shtetit. Me nisjen e procesit të ri mësimor, Hita kërkoi që shërbimet e Policisë të jenë maksimalisht të angazhuara, në bashkëpunim me oficerët e sigurisë në shkolla, për të garantuar sigurinë e nxënësve dhe zhvillimin normal të procesit mësimor.

Ai u kërkoi shefave të komisariateve që ta ndjekin çdo ditë këtë prioritet dhe të trajtojnë personalisht çdo shqetësim të adresuar nga drejtuesit e shkollave që lidhet me sigurinë e nxënësve.

Sipas porositve të dhëna, Sektorët e Narkotikëve, forcat "Shqiponja" dhe strukturat operacionale do të jenë të përqendruara në perimetrin e sigurisë së shkollave, për të parandaluar çdo tentativë për shpërndarje të lëndëve narkotike apo përfshirje në konflikte me nxënës.

Në drejtim të sigurisë rrugore, Drejtori i Përgjithshëm kërkoi intensifikimin e monitorimit të qarkullimit, përfshirë përdorimin e mjeteve inteligjente, me synim parandalimin e aksidenteve dhe ndërhyrjen e menjëhershme ndaj çdo shkeljeje të konstatuar.

Hita kërkoi gjithashtu që çdo drejtues policie të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për situatën e sigurisë në territorin që mbulon, duke ndjekur nga afër problematikat dhe duke garantuar reagim të shpejtë e profesional ndaj çdo shqetësimi të qytetarëve.

Ai u bëri thirrje shefave të komisariateve dhe drejtorëve të qarqeve të presin qytetarët, t'i dëgjojnë për çdo problem që lidhet me punën e Policisë dhe të jenë pjesë e zgjidhjes së tyre. Hita theksoi se edhe ai vetë pret çdo qytetar që kërkon takim.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rëndohen ndëshkimet, shtohen shkeljet/ Pas ndryshimit të kodit rrugor, më shumë shpejtësi, parakalim e alkool](#)

13:05 Kronika

Kreu disa vjedhje në Shkodër, arrestohet 20-vjeçari! Dyshohet se bashkëpunonte me një të mitur

11:55 Kronika

Zjarret në vend/ 735 forca dhe 64 zjarrfikëse në terren, angazhohen edhe helikopterë e Air Tractor

11:45 Kronika

Goditet rrjeti i drogës në Sarandë, arrestohen të gjithë të dyshuarit! Në pranga edhe një emër i njohur i qytetit

11:08 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.